



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.85/2017

Prishtinë, më 31.1.2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Glauk Konjufca, zëvendëskryetar i parë, Raif Qela, Sala Berisha- Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Rustem Berisha, Enver Hoti, dhe Duda Balje, anëtarë, si dhe Shaip Muja, deputet.

Munguan: Sasha Milosavljeviq, zëvendëskryetar i dytë dhe Besim Beqaj, anëtar.

Pjesëmarrës të tjerë: Selvie Çeku, MTI; Majar Logar dhe Emrush Ujkani, SAA-SD Projekt; Amir Kozmaqi, INDEP; Etleva Malushaj, LVV; Fjolla Uka, KDI dhe Sylejman Blaku, - Kosova Sot.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Veton Raci dhe Erëza Hasani, praktikante e Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.1.2017;
3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr.05/L-130 për shërbime;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-128 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minalet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit të ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.01.2017

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 24.1.2017, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-130 për shërbime

Kryetari tha se lidhur më këtë pikë të rendit të ditës, grupi punës e ka punuar projektligjin për Shërbime dhe i ka formuluar amendamentet të cilat sot do t'i diskutojmë, ku kryesues i grupit të punës është z. Rustem Berisha, të cilit ia kaloi faljen për të paraqitur raportin më amendamente.

Rrustem Berisha raportoi se grupi i punës e ka shqyrtuar projektligjin për shërbime ku ka ftuar edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si sponsorues të projektligjit dhe ekspertët që kanë marrë pjesë në takim. Grupi punës i ka nxjerrë gjithsej 14 amendamente. të cilat i kanë sot për shqyrtim dhe janë pothuajse teknike. Po ashtu e keni edhe një listë më shërbime që na e ka sjellë ministria sipas kërkesës tonë. Në jemi të gatshëm të arsyetojmë secilin amendament.

Kryetari tha se ne kur e shqyrtuam projektligjin në parim, nuk e kishim të qartë së çka prej shërbimeve nuk është e rregulluar, ndërsa sot e kemi marrë prej ministrisë një pasqyrë në mënyrë tabelore se cilat janë ato shërbime. Andaj, arsyetimi i projektligjit duket së është shumë evidente, kështu që vazhdojmë më diskutim.

Raif Qela tha se ky projektligj dhe amendamentet e tij duket që e kanë plotësuar zbrazëtinë që i ka lenë vetë projektligji. Edhe pse duket që nuk janë përmbajtjesore, amendamentet i kanë qartësuar do referenca që tregon së është përmirësuar projektligji, prandaj edhe për këtë e përgëzoj grupin e punës. Unë do të ndalesha në një fushë tjetër, ky projektligj për dallim prej projektligjeve të tjera, që kanë ardhur prej ministrisë, është projektligj relativisht mirë i hartuar dhe ka shumë pak gabime gjuhësore dhe është për t' u lavdëruar në krahasim prej projektligjeve të tjera. Nëse pajtoheni tekstin i cili është i amendamentuar, më korrigjimet e mia ua kam dërguar më e-mail me rregullimet drejtshkrimore.

Komisioni miratoi përmirësimet drejtshkrimore të proceduara më shkrim nga deputeti Raif Qela, në Amendamentet 1, 2, 6,13 dhe 14.

Kryetari hodhi në diskutim secilin Amendamente një nga një, të cilët i arsyetoj kryesuesi i grupit të punës, deputeti Rustem Berisha.

Amendamenti 1

Riformulohet titulli i nenit 3.

Miratohet nga Komisioni.

Amendamenti 2

Neni 4, në tërë tekstin e këtij neni fshihet fjala “nënkupton”.

Miratohet nga Komisioni.

Amendamenti 3

Neni 4, nënparagrafi 1.4. riformulohet.

Miratohet nga Komisioni.

Raif Qela, propozoj të shtohet një amendament i ri, të titulli i nenit 7, sepse titulli “Thjeshtëzimi i procedurave” duhet të ndryshohet sepse “thjeshtëzimi” do të thotë paraqitja më e thjeshtë se sa që është e diçkaje, e jo më i thjeshtuar procedurat, andaj, është përmbajtjesore dhe duhet të jetë “Thjeshtësimi i procedurave” dhe paraqiti amendamentin si vijon:

Amendamenti 4

Titulli i Nenit 7, riformulohet si vijon: "Thjeshtësimi i procedurave"

Komisioni miratoj propozimin e deputetit Raif Qela.

Amendamenti 5

Titulli i nenit 13, riformulohet.

Miratohet nga Komisioni.

Amendamenti 6

Neni 13, paragrafi 3, fjalia “paragrafit 2 të këtij ligji” zëvendësohet me “paragrafit 2 të këtij neni”.

Miratohet nga Komisioni.

Amendamenti 7

Neni 14, paragrafi 1, riformulohet.

Kryetari tha pajtohem me amendamentin, por duhet t’ ia shtoni tekstin: “dhe informatat e nevojshme”.

Komisioni miratoi propozimin e kryetarit.

Amendamenti 8

Neni 14, paragrafi 3, fjalia “paragrafi 2 të këtij Ligji” zëvendësohet me “paragrafi 2 të këtij neni”.

Miratohet nga Komisioni.

Amendamenti 9

Neni 15, në paragrafët 2, 3 dhe 4, fjala “i lartë përmendur” pas referencave në kuadër të paragrafit zëvendësohet me fjalinë “të këtij neni”.

Miratohet nga Komisioni.

Amendamenti 10

Neni 18, në paragrafët 2, 3 dhe 4, fjalitë “2. Akti i veçantë ligjor; 3.Me ligj të veçantë apo akt nënligjor; 4. Nëse me akt të veçantë ligjor” zëvendësohen me fjalinë “Legjislacion/ i/të veçantë”.

Miratohet nga Komisioni.

Amendamenti 11

Neni 19, paragrafi 1, fjalia “me ligj të veçantë apo akt nënligjor.” zëvendësohet me “legjislacion të veçantë”.

Miratohet nga Komisioni.

Amendamenti 12

Neni 22, në paragrafin 1, fjalia “në paragrafin 1 të nenit 21” zëvendësohet me “në nenin 21 paragrafi 1, i këtij Ligji” si dhe fjalia “në paragrafin 2 të nenit 9, nenit 18 dhe 20 të këtij ligji,” zëvendësohet me “në nenin 9 paragrafin 2, nenin 18 dhe 20 të këtij ligji.”

Miratohet nga Komisioni.

Amendamenti 13

Neni 23, nënparagrafin 1.1. fshihet.

Miratohet nga Komisioni.

Amendamenti 14

Neni 28, paragrafi 2, riformulohet.

Miratohet nga Komisioni.

Amendamenti 15

Neni 30, riformulohet.

Miratohet nga Komisioni.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet Raporti me amendamente i Projektligji nr.05/L-130 për shërbime.

2. *Raporti me amendamente i Projektligji nr.05/L-130 për shërbime procedohet në Komisionet e përhershme për vlerësim sipas kompetencës.*

3. *Autorizohet stafi i Komisionit të bëjë rregullimin gjuhësor të amendamenteve sipas propozimeve të deputetit Raif Qela.*

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-128 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158

Kryetari tha se këtë çështje që sot është pikë e rendit të ditës, kemi diskutuar edhe në mbledhjen kur kemi nxjerrë konkluzionin në bazë të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për miniera dhe minerale, që rekomandohet të filloj nisma e plotësim- ndryshimin e këtij ligji, po ashtu në të njëkohësisht dhe deputeti z. Shaip Muja e ka iniciuar procedurën për plotësim ndryshim e ligjit për miniera dhe minerale. Deputeti Muja është këtu i pranishëm për ta dhënë opinionin lidhur me propozimin e tij dhe ia kaloi fjalën për të e paraqitur në parim projektligjin.

Deputeti Shaip Muja, siç jeni në dijeni, tha se Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor e ka miratuar Ligjin për Obilinqin, dhe pas një debati maratonik dhe problemet të cilat janë paraqitur nga ne, si propozues që nga Legjislatura e kaluar, kanë qenë nene të cilat jemi munduar t'i kompensojmë në njëfarë mënyre që të mos sjellim kolizion me ligjet e tjera në Republikën Kosovës. Neni i cili është kërkuar atëherë ka qenë “tantiema” dhe unë kam kërkuar si udhëheqës i nënkomisionit të krijuar për këtë ligj, ta shpërndajë në zëra ministrorë, në projekte të planifikuara 5 (pesë) vjeçare dhe ta heqim tantiemën nga ai nen i Ligjit për Obilinqin dhe pothuajse gati një vit nuk kam hasur në mirëkuptim ose në një qasje pozitive nga Qeveria. I kam ftuar me radhë Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që në emrin e kësaj tantiemës që të zotohemi dhe të bëhet një plan strategjik 5 (pesë) vjeçar dhe të jetë në kuadër të këtij ligji në atë formë e precizuar dhe të iket nga kjo pjesa e tantiemës për shkak të interpretimeve të ndryshme. Pas miratimit të Ligjit të Trepçës që ne e kemi miratuar, këtu shihet që tantiema në nenin 16 nëse nuk gaboj, është e përcaktuar që të bëhet 20% në Ligjin e Trepçës, dhe, unë menjëherë e kam marrë, meqenëse ne për Trepçën e kemi miratuar dhe i bie që të jetë ligj selektiv dhe kam kërkuar që të miratohet ashtu dhe të lihet tantiema në Ligjin për Obilinqin dhe të bëhet ndërhyrje të Ligji për Miniera dhe Minerale, të pjesa e rentës minerale që mblidhet dhe 20% të kalohet në buxhetin komunal. Interpretimet, që ju tani i keni marrë nga Ministria e Financave të cilët thonë se bie ndesh, mendoj kjo nuk bie ndesh me Ligjin për Financat Publike, por duhet me u mbledhur dhe me rishikuar dhe me riemërtuar edhe të Ligji për Financat Publike problemin e adaptimit ose të dy ligjeve aktuale atë të Trepçës dhe të Obilinqit duhet t'i shpallim të pavlefshëm. Nuk e di pse një interpretim i tillë, mirëpo, unë kam krijuar idenë se ne kemi një administratë shumë të dobët të ministrive dhe ministrat nuk kanë kohë as me u fokusuar dhe me e analizuar, sepse nëse ishte analizuar kjo mirë dhe nëse propozohet qartë, ne mund ta adaptojmë shumë shpejt dhe të jenë të kënaqur sepse komuniteti në Obilinq do ta politizojë dhe do ta kapitalizojë politikisht këtë problem, se ne jemi të pavullnetshëm që t'i implementojmë ligjet që po i miratojmë. Problemi tjetër është tash i paraqitur se fundmi në Komisionin tonë për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor, prapë ne kemi nisur një iniciative të cilën unë e kam kundërshtuar, të cilën e kanë propozuar kolegët e mi, Ligj të veçantë për fshatin Hade. Dua të ju

sqaroj juve si koleg i juaji pasi besoj që edhe ju jeni të informuar për këtë punë, nëse tani më ia lejon komunës së Obiliqit në emrin e subvencioneve që i merr, t'i reduktohen subvencionet Obiliqit dhe t'i lejohet tani dhe komunave të tjera dhe në fshatin Hade, të intervenohet nga pjesa e tani më me një afat prej 2 (dy) vitesh, pothuajse me tani më ju paguajmë shtëpitë dhe ne rast nëse bën zgjerim Elektroekonomia e Kosovës në mihjen sipërfaqësore dhe vije puna e marrjes se tokave në shfrytëzim për KEK-un, atëherë pagimi i këtyre tokave do të vijë nga KEK-u në të ardhmen. Mirëpo, këta e kanë paraqitur në vitin 2033 që do të ju bëhet, ndërsa shtëpitë atje nuk kanë kushte as për jetesë, për ata po them nuk ka pasur vullnet as politik, as logjik për ta zgjedhur këtë problem. Ne tani kemi ardhur në një pikë ku unë kërkoj nga ju që ta miratojmë këtë nismë që e kam propozuar. Unë e di që ju jeni duke punuar në ndryshim plotësimin e Ligjit për Miniera dhe Minerale, mirëpo ajo nëse nuk e miratojmë ne shpejt këtë amendament kjo do të shtyhet për vitin e ardhshëm dhe nuk do të ketë mundësi të implementimit, ndërsa dy ligjet që i kemi këtu janë logjikisht të pa implementueshme. As Ligji për Trepçën nuk mundet me u implementuar. Ne me këtë ligj kemi fituar se bëmë njëfarë lloj makijazhi politik për ta shpëtuar nga një lloj privatizimi, ndoshta edhe pse s'po dua tani me e interpretuar, ndërsa te Ligji për Obiliqin është i paimplementueshëm sepse ne në nenin 9 nëse nuk gaboj ose 8, ne kemi paraparë që tani më prej 20% të ndahet në Obiliq. Mirëpo nëse e lejon tani vetëm Obiliqin prapë kemi bërë politik selektive. Ne duhet ta implementojmë në nivel të Kosovës dhe ky ligj të përfshijë edhe gurthyesit dhe shfrytëzuesve të tjerë të mineraleve edhe në komunat e tjera edhe SharrCem dhe të tjera.

Kryetari është fakt që ne e kemi iniciuar çështjen e tani më në Ligjin për Trepçën sepse është një praktikë e avancuar ndërkombëtare sepse komunitetet ku nxirën mineralet, "komunitetet" jo "komunat" dhe ky është një dallim në mes nesh d.m.th. në mes të qasjes tonë nga qasja e juaj. Ky nuk është buxhet komunal, ti fole për komunat, nuk i përmende komunitetin d.m.th. nisja jonë ka të bëjë me komunitetin minerar sepse ai duhet të përfitojë në aspektin e mjedisit, të infrastrukturës, arsimit, kulturës, sportit etj. për arsye se komunitetet minerare janë me të goditura çdo here. Ligji për Trepçën është duke u zbatuar dhe është plotësisht i zbatueshëm dhe në pajtim të plotë me Kushtetutën i verifikuar edhe nga Gjykata Kushtetuese. Sepse Ligji i Trepçës për çështjet që i ka rregulluar zbatohet me një nen, ku ka prioritet për secilën çështje që e ka rregulluar dhe jo nga ligjet e tjera, është e cekur qartë në Ligjin e Trepçës, për atë të thashë se Ligji i Trepçës zbatohet. Por ne kemi diskutuar këtu edhe kur e kemi monitoruar dhe si Komision nuk kemi dilema se përdorimi i tani më për nevojat e komuniteteve minerare. Pra, ne jemi pro, nuk kemi dilema, por tash si duhet ta formulojmë dhe ta zgjedhim këtë problem me Ligjin për Financa publike dhe ligjet e tjera, me Ligjin për Miniera dhe Minerale mbetet që të rregullohet. Mendimi ynë ka qenë që menjëherë duhet me filluar me këto ndryshime dhe në kuadër të atyre ndryshimeve sepse janë ndryshime mjaftë komplekse midis ligjeve që pengojnë zbatimin me efikas të Ligjit për Miniera dhe Minerale dhe ne jemi në konsultim që kjo të filloj menjëherë. Ne i kemi dërguar shkresë ministrisë se a dëshiron ministria ta marrë përsipër ndryshimin e këtij ligji ose ne, mandej do ta kemi një komision që do t'i bëjmë ndryshimet me pjesëmarrje të ministrisë, meqë jeni të interesuar për këtë çështje do të mund të inkuadroheni edhe ju, mendimi ynë është që të mos punojmë paralelisht në dy-tri punë.

Shaip Muja tha se nëse implementohet Ligji i Trepçës, neni 13 i saj është, po ashtu Ligji për Obiliqin, neni 9 duhet të implementohet, nuk ka formë tjetër interpretuese, nga miratimi në Kuvend në seancë plenare janë miratuar të dy ligjet.

Kryetari tha se nëse mund të zbatohet, lë të zbatohet, pse jo, ne e kemi votuar Ligjin për Obiliqin.

Shaip Muja tha se ne nuk guxojmë kryetar të themi nëse mundet, sepse po e demantojmë vetveten dhe angazhimin tonë dhe komunitetin. Nëse, neni 9 i Ligjit për Obiliqin dhe neni 13 i Ligjit për Trepçën janë identike edhe neni i Ligjit për Miniera dhe Minerale duhet të jetë dhe nëse nuk shpërndahet tani edhe në krejt zonat e tjera të Kosovës, në çdo interpretim - ky është një interpretim selektiv, i cili është i papranueshëm, ajo çka kam kërkuar është se komunitetet me përfituar në çdo vend ku shfrytëzohen mineralet.

Kryetari tha se ne e kemi aprovuar Ligjin për Obiliqin dhe kur e aprovojmë ne mendojmë që implementohet dhe nëse dikush nuk e implementon duhet të japë arsye. Unë thashë për Ligjin e Trepçës, ai implementohet, sepse ai ka përparësi prej të gjitha ligjeve për çështjet që i rregullon. Është një nen ku ia jep atë fuqi atij ligji, nuk e di a ka ndonjë nen të tillë te Ligji për Obiliqin, këtu është dallimi në mes të Ligjit për Obiliqin dhe Ligjit të Trepçës.

Raif Qela tha se me rekomandimet e Komisionit të cilat janë miratuar edhe nga Kuvendi lidhur me mbikëqyrjen e Ligjit për Miniera dhe Minerale, e kemi obliguar Kuvendin që të inicioj procedurën për plotësim - ndryshim të ligjit dhe jo për ligj të ri. Nëse mbetet çështja për të krijuar një ligj të ri sigurisht do të shkoj edhe një vit, e ndoshta edhe me shumë sepse po i shohim procedurat burokratike që bëhen, sidomos nëse nisen nga Qeveria. Ashtu siç e kam thënë herën e kaluar, goxha jam i bindur se ne nuk kemi kapacitete për të iniciuar procedurë për ligj të ri, kurse për plotësim ndryshim mendoj se kemi kapacitete dhe nëse e bëjmë plotësim ndryshimin unë jam dakord që edhe amendamenti i deputetit Shaip Muja të inkorporohet në të. Nëse mbetet çështja që të iniciohet ligji i ri, unë them që amendamenti i deputetit Shaip Muja duhet të procedohet dhe të miratohet sepse e pengon realizimin e dy prej ligjeve të cilat vetë i kemi miratuar edhe Ligjin për Trepçën edhe Ligjin për Obiliqin. Plotësim- ndryshimi i cili është në frymën e asaj se qysh ka ardhur në përfundim edhe grupi punues në monitorimin e Ligjit për Miniera dhe Minerale, nëse plotësohet në atë frymë hap rrugë që të implementohen të dyja këto ligje, përndryshe ka mundësi që edhe kjo të jetë pengese edhe ne implementimin e atyre dy ligjeve dhe kjo është në kundërshtim me atë që ne kemi dashtë si Kuvend dhe si Komision. Prandaj, nëse duam ligj të ri duhet amendamenti i deputetit Muja të kalojë në mënyrë që dy prej ligjeve të mund të implementohen, përndryshe nëse mbetet çështja që të iniciojmë Ligj të ri për Miniera dhe Minerale, atëherë amendamenti i deputetit Muja mund të inkorporohet në plotësim ndryshimin e Ligjit për Miniera dhe Minerale.

Sala Berisha – Shala tha se angazhimin i deputetit Muja në këtë çështje e vlerësoj dhe është shumë i rëndësishëm, kjo tregon se kur një deputet dëshiron të angazhohet nuk kufizohet vetëm në ato komisione ku janë zyrtarisht të angazhuar dhe vlen për ta përsëndetur. Mirëpo, kjo ka qenë një tip mungese e komunikimit në kohën kur deputeti Muja është angazhuar dhe e ka identifikuar si nevojë të posaçme që pas miratimit të Ligjit të Trepçës dhe pas miratimit të Ligjit për Obiliqin që është e nevojshme dhe e domosdoshme që çështja të cilën e ka ngritur si amendament duhet të vlejë për tërë Kosovën dhe për tërë komunitetin që shfrytëzon pjesë ku bëhen operime minerare. Ndërkohë, edhe ne, si grup punues, që e kemi monitoruar ligjin për miniera dhe minerale e kemi identifikuar si nevojë dhe po ashtu ka qenë kërkesë e komunitetit ku bëhen operime minerare, kemi identifikuar edhe çështje të tjera shumë të rëndësishme dhe kemi ardhur në përfundim edhe si grup punues edhe si Komision që duhet të plotësohet-ndryshohet dhe

eventualisht të bëhet një ligj komplet i ri. Ne duhet ta dimë se a është e gatshme ministria të iniciojë një ligj të ri apo nëse ata janë të gatshëm të na përkrahin me kapacitete e tyre ligjore nëse ne e marrim një iniciativë për ligj të ri. Unë mendoj që ne kemi kapacitete edhe që të iniciojmë ligj të ri. Ne kemi bërë nisma ligjore edhe kur nuk kemi pasur asnjë dokument bazë siç ka qenë Ligji për Shërbimin Gjeologjik dhe Ligji për Siguri në Punë e në Veprimtari Minerare, e shumë ligje të tjera që kemi filluar nga zero dhe i kemi bërë ligje funksionale, përkundrazi hapat janë më të shpejtë kur nismat i merr Kuvendi se sa kur këto nisma vijnë nga Qeveria. Ne duhet të angazhohjmë edhe kapacitete jashtë Kuvendit edhe dikasteret që drejtpërdrejtë preken nga ky ligj dhe janë të obliguara t'i zbatojnë vendimet tona, pastaj do ta inkorporojmë si amendament të posaçëm edhe nismën e deputetit Muja. Mendoj që ky ligj nuk duhet të vazhdojë me tutje me plotësim ndryshime sepse i ka pësuar dy ose tri ndryshime nga viti 2008, sepse nga ai ligj bazik i 2008 kanë dal edhe dy ligje të tjera kështu që ky ligj si plotësim ndryshim nuk do ta kishte një kuptim sepse edhe ashtu do të ketë probleme në zbatim, në mënyrë që të jetë me i zbatueshëm duhet të jetë një ligj i ri.

Blerim Grainca, tha mendoj se duhet me punuar në 3-4 ligje të cilat duhet ndryshohen, duhet plotësohen, duhet harmonizohen, por nuk është çështje procedurale kjo, kjo është më shumë çështje konsencuale, ku fillimisht do të ishte mirë ose po besoj që jemi dakord për atë se komuna duhet të fitojë nga rretet minerale nëse në parim pajtoheni për këtë, atëherë është lehtë me gjetur rrugën, zgjidhjen, procedurën. Kemi dy mundësi pavarësisht a e bëjmë ligj të ri apo e bëjmë ndryshim, ne mund ta bëjmë një grup punues qoftë brenda komisionit, ta marrim si nismë ligjore qoftë amendamentet e zotëri Muja, qoftë si nismë të re. Në parim unë nuk shoh asgjë të keqe që edhe komunat të përfitojnë, megjithatë duhet gjetur formulën bashkë edhe duhet të mos bien ndesh me ligjin për financa publike edhe me ligjin për Trepçën. Kështu që, nuk ka asgjë të keqe që kjo të harmonizohet me të gjitha ligjet, unë jam për atë që të bëjmë një nismë ligjore, ta nisim sa ma shpejt procedurën për amendamentim të ligjit në cilindo variant kjo mund të kryhet shumë shpejt nëse kemi konsensus, por nëse ndërrojmë në qëndrime atëherë kjo nuk na shpie askund.

Kryetari tha se ne kemi debatuar edhe javën e kaluar dhe kemi konkluduar që të kërkojmë edhe mendimin e ministrisë. Unë kam folur me ministrin. Ai është i gatshëm qoftë njëherë, qoftë tjetrën variant, prandaj ne kemi caktuar një mbledhje sot një javë në ora 10:30 me ata, kështu që menjëherë mbledhjen që vjen të marrim qëndrimin. Ata përgjigjen zyrtare me shumë kanë thënë që më e marr komisioni për arsye se ata si duket janë të zënë, por ne së pari do ta vlerësojmë a do të shkojmë me ligj të ri apo me ndryshime dhe plotësime. Duhet ta cekim edhe njëherë që është pak problematike, nuk është identike qysh e kemi ligjin për Trepçën, e dyta po ua tërheq vërejtjen sepse ligji për Trepçën ka prioritet mbi të gjitha ligjet kështu që do zbatohet dhe aty s'ka diskutim. Por në procedurë e diskutojmë sepse sot po flasim në parim, pra ideja për ne është e pranueshme, vetëm qasja e mëtutjeshme qysh do të shkojmë. mendimi jonë, i komisionit është që në qoftë se punojmë me plotësim dhe ndryshim të ligjit që kjo të inkuadrohet në përpjekje të përbashkëta, pra për tërë Kosovën, por të jetë e rregulluar në atë mënyrë që të mos pengohet zbatimi i saj edhe të sqarohemi edhe me Ministrinë e Financave, edhe me Qeverinë, sepse ne jemi të bindur që komunitetet ku janë minierat duhet me përfituar prej rentës minerale. Ky është një standard ndërkombëtar i avancuar, edhe ne jemi një vend ku ka shumë miniera dhe e bazojmë zhvillimin në miniera, por duhet të kemi kujdes për zhvillim të komuniteteve minerale, ky ka qenë mendimi ynë.

Shaip Muja kur thashë që administratat në nivel të ministrive është e cekët edhe nuk janë të interesuar as me u fokusuar, unë nuk e thashë rastësisht, ministrave as që ju ka interesuar me u marr me këtë shqetësim. Por në Legjislacionin e kaluar ka qenë zotëri Danka dhe, problemet e krijuara në komunitet e Obiliqit që është edhe në zonat e kontaminuara, është përkushtim minimal i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, edhe i kësaj qeverie. Nëse ne ndërhyjmë shpejt edhe ju në ndërkohë mundeni me përgatit ligjin në tërësi. Por, mu ky ligj nëse nuk ndahet renta minerale në mënyrë uniforme në krejt komunat interpretimi është selektiv, as Trepça nuk mundet me u implementuar me këtë kapitullin që e ka bërë nenin 17, ndërsa vetë titullimi i ligjit e mbron ligjin e Obiliqit si zonë e rrezikuar e veçantë d.m.th. në mënyrë më pak të zgjeruar. Tash mos me fol veç për Obliqin edhe veç për Trepçën, po shkojmë në krejt Kosovën. Tash këta e kanë arsyetuar profesor, Ministria e Financave, ju e keni lexuar arsyetimin, kanë thanë: “neni i parashtruar bie ndesh me Ligjin për financa të pushtetit lokal në të cilin është rregulluar mënyra e financimit të komunave”. Ky arsyetim nuk vlen. E mandej mundohen me u arsyetuar ku thuhet se: “ne buxhetin për vitin 2017 e kemi paraparë që shumë nga 33 milionë euro nga renta minerale që mbledhet në Kosovë nga KPMM-ja”. D. m. th, ne e kemi paraparë dhe tash ne nuk mundemi me lëviz, pra po them me u ngut me miratuar këtë amendament dhe në rishikim me pa sepse edhe këta nëse ja ndajnë komunës, nuk mundet komuna me i shfrytëzuar këto mjete pa pasur edhe planifikim. Kështu që tërë viti 2017 ka me qenë procedim ligjor, planifikim, rialokim në rishikim të buxhetit në qershor dhe tek me filluar me implementuar në janar të vitit 2018, në të kundërtën unë po e shoh që nuk ka me pasur hapësirë.

Kryetari, atëherë po propozojë që si Komision, qëndrimin definitivë ta marrim mbledhjen e ardhshme, pas diskutimit që do ta bëjmë lidhur me atë se a do të shkojmë me ndryshime dhe plotësime të ligjit apo do të shkojmë me ligj të ri.

Pas debatit, Komisioni nxori:

Konkluzion

Shtyhet për mbledhjen e radhës shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-128 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158.

5. Të ndryshme Çështjet vijuese

Mbledhja përfundoi në ora 12:15.

**E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa